REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 244/1 Prot. Datë 03 / 01 / 2026

KARTA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Qëllimi

Qëllimi i funksionit të auditimit të brendshëm është të forcojë aftësinë e Bashkisë Lezhë për të krijuar, mbrojtur dhe mbështetur vlerën duke i ofruar titullarit dhe menaxhimit siguri, këshilla, njohuri dhe largpamësi të pavarura, të bazuara në risk dhe objektiva.

Funksioni i auditimit të brendshëm përmirëson Bashkinë Lezhë për:

- Arritjen me sukses të objektivave të saj.
- Qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe proceset e kontrollit.
- Vendimmarrjen dhe mbikëqyrjen.
- Reputacionin dhe besueshmërine me palet e interesuara.
- Aftësinë për t'i shërbyer interesit publik.

Në zbatim të ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar dhe Urdhërit të Ministrisë së Financave Nr.134, datë 17.10.2025 Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik. auditimi kryhet nga profesionistë kompetente në përputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm., të miratuara nga Ministria e Financave. Funksioni i auditimit të brendshëm është i pozicionuar në mënyrë të pavarur me llogaridhënie të drejtperdrejtë ndaj titullarit. Audituesit e brendshëm janë të lire nga ndikimi i padrejte dhe duhet të bëjnë vlerësime objektive. Drejtuesi i auditimit të brendshëm do të raportojë në mënyrë periodike, çdo vit, tek titullari në lidhje me përputhshmërinë e funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet, të cilat do të vlerësohen përmes një programi për sigurimin dhe përmirsimin e cilësisë.

Autoriteti

Në Bashkinë Lezhë funksioni i auditimit të brendshëm ka mandat për t'i ofruar titullarit të njesisë publike siguri objektive, këshillim të pavarur, njohuri të vlefshme dhe perspektive largpamëse për të përmiresuar proceset organizative dhe qeverisjen. Autoriteti i funksionit të auditimit të brendshëm krijohet nga marëdhënia e tij e raportimit të drejtpërdrejtë ndaj titullarit. Nje autoritet i tillë lejon akses të pakufizuar të titullari.

Titullari autorizon funksionin e auditimit të brendshëm për:

- Të kryer angazhime të auditimit të brendshëm në pajtueshmëri me kerkesat e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi.
- Të patur akses të plotë dhe të pakufizuar në të gjitha funksionet, të dhënat, informacionin, pronën fizike dhe personelin, që lidhet me kryerjen e përgjegjësive të auditimit të brendshëm. Audituesit e brendshem janë përgjegjes për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit.
- Të ndarë burimet, vendosur frekuencat, zgjidhur lëndën, përcaktuar fushëveprimin e punës, aplikuar teknikat dhe dërguar raportet për të përmbushur objektivat e funksionit.

- Të marrë ndihmë nga personeli i nevojshem i Bashkisë Lezhë dhe sherbime të tjera të specializuara brenda ose jashtë Bashkisë Lezhë, për të përfunduar shërbimet e auditimit të brendshëm.

Pavarësia, Pozicioni Organizativ dhe Marëdhëniet Raportuese

Njësia e auditimit të brendshëm do të pozicionohet në një nivel në njësinë publike që mundëson që shërbimet dhe përgjegjesitë e auditimit të brendshëm të kryhen pa ndërhyrje nga menaxhimi, duke vendosur kështu pavaresinë e funksionit të auditimit të brendshëm. Drejtuesi i auditimit të brendshëm do t'i raportoje funksionalisht dhe administrativisht titullarit. Ky pozicionim siguron autoritetin dhe statusin organizativ për të sjelle çështjet drejtperdrejtë tek titullari, pa ndërhyrje dhe mbështet aftësinë e audituesve të brendshëm për të ruajtur objektivitetin.

Drejtuesi i auditimit te brendshem i konfirmon titullarit, të pakten një here në vit (si pjesë e raportit vjetor), pavaresinë organizative të funksionit të auditimit të brendshëm. Nëse struktura e qeverisjes nuk mbështet pavarësinë organizative, Drejtuesi i auditimit brendshem do të dokumentojë karakteristikat e strukturës së qeverisjes, që kufizojnë pavarësinë dhe çdo masë mbrojtëse të përdorur për të arritur parimin e pavarësisë.

Drejtuesi i auditimit brendshëm i raporton titullarit çdo ndërhyrje që hasin audituesit e brendshëm në lidhje me fushëveprimin, performancën ose komunikimin e punës dhe rezultateve të auditimit të brendshëm. Raportimi përfshin rastet e nderhyrjes të tilla që ndikojnë në efektivitetin dhe aftësine e funksionit të auditimit të brendshëm për të përmbushur mandatin e tij.

Mbikëqyrja e Titullarit

Për të krijuar, mirëmbajtur dhe siguruar, që funksioni i auditimit të brendshëm në Bashkinë Lezhë ka autoritet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrat e tij, titullari duhet:

- Të diskutojë me drejtuesin e auditimit të brendshem autoritetin, rolin, përgjegjësitë, fushëveprimin dhe shërbimet (e sigurisë dhe /ose të këshillimit) të përshtatshme për funksionin e auditimit të brendshëm.
- Të sigurojë, që drejtuesi i auditimit brendshëm, të kete akses të pakufizuar në takimet me titullarin, si dhe të komunikojë e bashkëveprojë drejtperdrejtë me të, duke përfshirë takimet pa praninë e menaxhimit të lartë.
- Të diskutojë me drejtuesin e auditimit të brendshëm tema të tjera, që duhet të përfshihen në kartën e auditimit të brendshëm.
- Të miratojë kartën e auditimit të brendshëm, e cila përfshin, por jo vetem statutin e auditimit të brendshëm, fushëveprimin dhe llojet e shërbimeve të auditimit të brendshëm.
- Të miratojë planin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshem të bazuar në risk.
- Të rishikojë performancën e njësisë të auditimit të brendshëm.
- Të marrë komunikime nga drejtuesi i auditimit brendshëm në lidhje me funksionin e auditimit të brendshëm duke përfshirë performancën në zbatimin e planit/planeve të auditimeve të miratuar nga titullari.
- Të sigurohet, që është krijuar një program për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe të njihet me rezultatet vleresimeve të cilësisë çdo vit. Të kërkojë infomacion nga drejtuesi i auditimit të brendshëm për të përcaktuar nëse ka patur kufizime të fushëveprimit ose burimet janë të pamjaftueshme dhe papërshtatshme.

Rolet dhe Përgjegjësitë e Drejtuesit të Auditimit të Brendshëm

Etika dhe Profesionalizmi:

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të sigurojë, që audituesit e brendshëm:

- Të veprojnë në perputhje me kuadrin ligjor e nënligjor si dhe Standardet Globale të Auditimit te Brendshëm duke përfshirë parimet e Etikës dhe Profesionalizmit si, integritetin, objektivitetin, kompetencat, kujdesin e duhur profesional dhe konfidencialitetin.
- Të kuptojnë, të respektojnë, të përmbushin kërkesat e arsyeshme dhe të drejta, që burojnë nga ligji, standardet profesionale dhe parimet etike.
- Të inkurajojnë dhe promovojnë një kulturë të bazuar në etikë.

Objektiviteti

Drejtuesi i auditimit të brendshëm do të siguroje, që funksioni i auditimit të brendshëm të mbetet i lirë nga të gjitha kushtet që kërcënojnë aftësinë e audituesve të brendshem për të kryer pergjegjësitë e tyre në një mënyrë të pa anshme, duke përfshirë çështjet e përzgjedhjes së angazhimit, fushëveprimit, procedurave, frekuencës, kohës dhe komunikimit. Nëse drejtuesi i auditimit të brendshëm përcakton se objektiviteti mund të jetë i cënuar në fakt ose në dukje, detajet e cënimit do t'u raportohen palëve përkatëse. Audituesit e brendshëm do të mbajne një qëndrim të paanshëm që u lejon atyre të kryejne angazhimet në mënyrë objektive, në menyrë që:

- Të jenë të besueshëm në punën e tyre,
- Të mos cënojnë cilësinë,
- Gjykimi i tyre të mos ndikohet nga faktorë të tjerë apo palë treta as në fakt as në dukje.

Audituesit e brendshëm nuk kanë përgjegjësi ose autoritet të drejtëpërdrejtë operativ mbi asnjë nga aktivitetet që ata shqyrtojnë. Prandaj, audituesit e brendshem nuk duhet:

- Të zbatojnë kontrolle brendëshme, të zhvillojnë procedura, të instalojne sisteme.
- Të angazhohen në aktivitete të tjera që mund të demtojnë gjykimin e tyre, duke perfshirë:
  - ✓ Vlerësimin e operacioneve specifike për të cilat ata kishin përgjegjësi brenda 3 viteve të kaluara, kryerjen e detyrave operative.
  - ✓ Kryerjen ose miratimin e transaksioneve jashtë funksionit të auditimit të brendshëm.
  - ✓ Drejtimin e aktiviteteve të punonjësve, që nuk janë të punësuar në njësinë e auditimit të brendshëm.

Audituesit e brendshem duhet:

- Të raportojnë shkeljet e pavarësisë dhe të objektivitetit, në fakt ose në dukje, tek palët përkatëse dhe të paktën një herë në vit, sic është drejtuesi i auditimit të brendshëm, tek titullari.
- Të tregojnë objektivitet profesional në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e informacionit.
- Të bëjnë vlerësime të balancuara të të gjithë fakteve dhe rrethanave të disponueshme dhe të rëndësishme. Të marrin masat e nevojshme për të shmangur konfliktet e interesit, paragjykimet dhe ndikimin e padrejtë.
- Të ruajnë konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave dhe informacionit të përfituar gjatë ushtrimit të detyrës si auditues.

Menaxhimi i Funksionit të Auditimit të Brendshëm

Drejtuesi i auditimit të brendshem ka përgjegjësinë:

Të planifikojë veprimtarinë e auditimit të brendshëm të bazuar në risk, që merr në konsideratë kontributin e titullarit dhe menaxhimit të lartë.

Të diskutojë planin me titullarin dhe më pas ia dorëzon atij për shqyrtim dhe miratim.

- Të komunikojë ndikimin e kufizimeve të burimeve në planin e auditimit të brendshëm tek titullari.
- Të rishikojë dhe të përshtatë planin e auditimit të brendshëm, sipas nevojës, në përgjigje të ndryshimeve në institucion, risqet, operacionet, programet, sistemet dhe kontrollet e instaluara.
- Të komunikojë me titullarin nese ka ndryshime të rëndësishme të ndërmjetme nëe planin e auditimit të brendshëm.
- Të sigurojë, qe angazhimet e auditimit të brendshëm të kryhen, dokumentohen dhe komunikohen në perputhje me Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm.
- Të ndjekë gjetjet e angazhimit, të konfirmojë zbatimin e rekomandimeve ose planeve të veprimit si dhe të komunikojë rezultatet e shërbimeve të auditimit të brendshem tek titullari, periodikisht dhe për cdo angazhim sipas rastit.
- Të sigurojë aftesitë, kompetencat dhe kualifikimet e tjera të nevojshme në zbatim të kërkesave të Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm me qëllim përmbushjen mandatit të auditimit të brendshëm.
- Të identifikojë dhe të marrë në konsiderate tendencat dhe çështjet e reja që mund të ndikojnë tek Bashkia Lezhë dhe t'i komunikojë ato tek titullari sipas rastit.
- Të marrë në konsideratë tendencat në zhvillim dhe praktikat e suksesshme në auditimin e brendshëm.
- Të vendosë dhe të sigurojë respektimin e metodologjive të hartuara për të udhëhequr funksionin e auditimit të brendshëm.
- Të sigurojë respektimin e politikave dhe procedurave përkatëse të Bashkisë Lezhë, perveç rasteve kur këto politika dhe procedura bien ndesh me kartën e auditimit të brendshëm ose Standardet Globale të Auditimit të Brendshëm. Çdo konflikt i tillë do të zgjidhet ose dokumentohet dhe do t'i komunikohet titullarit.
- Të kordinojë veprimtaritë dhe të marrë në konsiderate mbështetjen në punën e ofruesve të tjerë të brendshem dhe të jashtëm të shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit. Nëse drejtuesi i auditimit të brendshëm nuk mund të arrijë një nivel të përshtatshëm koordinimi, çështja duhet t'i komunikohet titullarit.

Raportimi i Drejtuesit të Auditimit të Brendshem tek Titullari

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të raportojë para titullarit në lidhje me:

- Statutin e funksionit të auditimit të brendshëm.
- Planet (Strategjik dhe Vjetor) të auditimit të brendshem dhe performancën në lidhje me realizimin e tyre.
- Rishikimet e planeve të auditimit të brendshëm.
- Cënimet e mundshme të pavarësisë, duke përfshirë edhe deklarimet përkatëse sipas rastit.
- Rezultatet nga programi i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë, të cilat përfshijnë përputhshmërinë e funksionit të auditimit të brendshëm me Standardet Globale të Auditimit të Brendshem të IAB (II A) dhe planet e veprimit për të adresuar mangësitë e funksionit të auditimit të brendshëm dhe mundësitë për përmirësim.
- Ekspozimet e rëndësishme ndaj riskut dhe çështjeve të kontrollit, duke përfshirë risqet e mashtrimit, çështjet e qeverisjes dhe fusha të tjera të fokusit për titullarin.
- Rezultatet e shërbimeve të sigurisë dhe këshillimit.
- Kërkesat për burime.

Përgjigjet e menaxhimit ndaj riskut, që funksioni i auditimit të brendshëm përcakton se mund të jenë të papranueshme ose pranimi i një risku që është përtej oreksit të riskut të Bashkisë Lezhë.

Raportimi tek Struktura Përgjegjese për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm duhet të raportojë:

- Kartën e Auditimit të Brendshëm të miratuar nga titullari.
- Planin Strategjik dhe Vjetor të miratuar nga titullari dhe ndryshimet në rastet kur ka.
- Raportin Vjetor të Veprimtarisë të miratuar nga titullari
- Raportin Vjetor të Zbatimit të Rekomandimeve
- Programin e Sigurimit të Brendshem të Cilesisë kur ka ndryshime.

Programi i Sigurimit dhe Përmiresimit të Cilësisë

Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të hartojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program për sigurimin dhe përmiresimin e cilësisë, që mbulon të gjitha aspektet e funksionit të auditimit të brendshëm. Vlerësimet e jashtëme do të kryhen të paktën një herë në pesë vjet nga një vlerësues i kualifikuar dhe i pavarur ose një ekip vlerësimi nga jashtë Bashkisë Lezhë.

Fushëveprimi dhe Llojet e Shërbimeve të Auditimit të Brendshëm

Fusha e shërbimeve të auditimit të brendshëm mbulon të gjithë universin e auditimit të Bashkisë Lezhë, duke përfshirë të gjitha aktivitetet, asetet dhe personelin. Fusha e aktiviteteve të auditimit të brendshëm përfshin gjithashtu, por nuk kufizohet vetëm në, shqyrtime objektive të evidencave për të ofruar shërbime të pavarura sigurie dhe këshillimi për tiullarin. Shërbimet e keshillimit duhet të dakortësohen me palën që kërkon shërbimin, me kusht që funksioni i auditimit të brendshem të mos marrë përsiper përgjegjësine e menaxhimit.

Angazhimet e auditimit të brendshëm

- Angazhimet e auditimit të brendshëm përfshijne vlerësimin nëse:
- Risqet që lidhen me arritjen e objektivave strategjike të Bashkisë Lezhe identifikohen dhe menaxhohen në mënyrë të përshtatshme.
- Rezultatet e operacioneve dhe programeve janë në përputhje me qëllimet dhe objektivat e përcaktuara.
- Operacionet dhe programet të kryhen në mënyrë efektive dhe efikase.
- Proceset dhe sistemet e vendosura mundësojnë pajtueshmërine me politikat, procedura, ligjet dhe rregulloret, që mund të ndikojnë ndjeshëm.
- Integriteti i informacionit dhe mjetet e përdorura për të identifikuar, matur, analizuar, klasifikuar dhe raportuar infomracione të tilla janë të besueshme.
- Burimet dhe asetet përfitohen në mënyrë ekonomike, përdoren në mënyrë eficente dhe të qëndrueshme si dhe mbrohen në mënyrë të përshtatshme.